



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtorë

Kryesia e Kuvendit
P-032
Prishtinë, më 16 shtator 2008, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT ME KRYETARËT E GRUPEVE
PARLAMENTARE, TË MBAJTUR MË 16 SHTATOR 2008**

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, dhe anëtarët e Kryesisë: Xhavit Haliti, Eqrem Kryeziu, Ibrahim Gashi, Nexhat Daci, Naim Maloku, Xhezair Murati dhe Slllobodan Petroviq, ndërsa mungoi Sabri Hamiti.

Nga grupet parlamentare: Ramë Buja, Lutfi Haziri, Lulzim Zeneli dhe Zylfi Merxha, ndërsa munguan Ibrahim Makolli, Ardian Gjini dhe Bojan Stojanoviq.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Skënder Reçica dhe Sherif Konjufca;

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi dhe Ismet Hajrullahu;

Nga NDI: Rinor Bekaj dhe

Nga OSBE: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Kryesia, me propozimin e Kryetarit, miratoi këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 9 shtator 2008,
2. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave, dhe
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 9 shtator 2008

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 9 shtator 2008, u miratuan me vërejtjen e anëtarit të Kryesisë, Xhavit Haliti, se ai në mbledhjen e mëparshme kishte munguar me arsye.

2. Propozimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme plenare

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë dhe kryetarët e grupeve parlamentare me materialet e përgatitura për seancën e radhës.

Kryesia, me propozim të Kryetarit, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare e radhës të mbahet më **25 shtator 2008**, me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i Procesverbalit të seancës së mëparshme,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndarjen e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës,
4. Shqyrtimi i propozimit për formimin e Komisionit Ad Hoc për përzgjedhjen e anëtarëve në Këshillin e Komisionit të Pavarur për Media.

Lidhur me shqyrtimin e parë të Projektligjit për të drejtat e ish të burgosurve politikë, Kryesia nxori këtë

P Ë R F U N D I M

I rekomandohet propozuesit të Projektligjit për të drejtat e ish të burgosurve politikë që të kërkojë nga Qeveria e Kosovës deklaratën për implikimet buxhetore për zbatimin e këtij ligji dhe deklaratën për përafrimin e tij me legjislacionin e Bashkimit Evropian, në pajtim me rregullat procedurale të Kuvendit dhe të Qeverisë.

Projektligji do të procedohet për shqyrtim të parë në Kuvend pasi të sigurohen deklaratat e cekura më lart.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave

3.1 Shqyrtimi i propozimit për emërimin e një anëtari në Këshillin e Komisionit të Pavarur për Media

Kryesia, shqyrtoi propozimin për emërimin e një anëtari në Këshillin e Komisionit të Pavarur për Media dhe lidhur me të nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga grupet parlamentare që Kuvendit t'ia propozojnë një kandidat për anëtar në Këshillin e Komisionit të Pavarur të Mediave, sipas nenit 4.3 të Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave.

3.2 Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi për zgjedhjen e Avokatit të Popullit

Kryesia shtyu shqyrtimin e rekomandimit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi për zgjedhjen e Avokatit të Popullit për mbledhjen e ardhshme.

3.3 Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit Drejtues të Trustit Pensional të Kosovës

Kryesia shqyrtoi propozimin e Qeverisë dhe lidhur me të nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Financa që ta shqyrtojë propozimin e Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit Drejtues të Bordit të Trustit Pensional të Kosovës dhe Kuvendit t'ia paraqesë rekomandimin lidhur me të.

3.4 Shqyrtimi i mocionit të deputetit Riza Smaka për të diskutuar në seancën plenare të radhës lidhur me propozimin e Serbisë për nxjerrjen e një Rezolute në OKB që Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë të japë mendimin për legalitetin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës

Kryesia konstatoi se shqyrtimi mocionit të deputetit Riza Smaka është i vonuar lidhur me çështjen e ngritur.

3.5 Shqyrtimi i kërkesës së Grupit joformal të grave deputete për lejimin e udhëtimit në Norvegji

Kryesia shqyrtoi kërkesën e Grupit joformal të grave deputete për lejimin e udhëtimit në Norvegji dhe konstatoi se ajo nuk është në përputhje me vendimin e Kryesisë nr. 02-2242-1/06.

Të ndryshme:

4.1 Njoftimi për formimin Grupit të ri Parlamentar

Kryesia shqyrtoi propozimin për formimin e Grupit të ri Parlamentar dhe lidhur me të nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Propozimi për formimin e Grupit të ri Parlamentar nuk i përmbush kushtet sipas rregullës 11. pika 1 dhe 4 të Rregullores së Punës së Kuvendit.

4.2 Raporti i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm

Kryesia vendosi që Raporti i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për auditimin mbi pasqyrat financiare të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2007 t'u shpërndalet deputetëve të Kuvendit.

4.3 Rekomandimi i Komisionit për Punë të Jashtme për lejimin e udhëtimit të katër (4) deputetëve dhe të katër (4) zyrtarëve në Sofje të Bullgarisë, më 1 dhe 2 tetor 2008.

Kryesia shqyrtoi rekomandimin e Komisionit për Punë të Jashtme, të prezantuar nga anëtari i tij, Xhavit Haliti, dhe të njëjtin e miratoi.

4.4 Shqyrtimi i mundësisë së angazhimit të një firme konsulente për hartimin e Rregullores së Kuvendit

Anëtari i Kryesisë, Xhavit Haliti, prezantoi ofertën e një firme konsulente për hartimin e Rregullores së Punës së Kuvendit.

Kryesia diskutoi lidhur me ofertën e cekur më lart dhe nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Të bëhen konsultimet me kryetarin e Komisionit për Rregulloren e Punës së Kuvendit, Mandate dhe Imunitete për nevojat e angazhimit të ndonjë firme konsulente.

4.5 Kompensimet shtesë për tejkalimin e shpenzimeve të fjetjes dhe të mëditjeve për qëndrimin e delegacionit të Kuvendit në SHBA

Kryesia shqyrtoi kërkesën për kompensimin e tejkalimit të shpenzimeve të fjetjes dhe të mëditjeve të delegacionit të Kuvendit të Kosovës në SHBA dhe lidhur me të mori këtë

V E N D I M

1. Miratohet tejkalimi i shpenzimeve të fjetjes dhe të mëditjeve për qëndrimin e delegacionit të Kuvendit kohë më parë në SHBA.
2. Ngarkohet sekretari i Kuvendit, që në bazë të praktikave të shteteve të rajonit, ta hartojë Propozim - Rregulloren për shpenzimet e udhëtimeve zyrtare jashtë vendit dhe t'ia paraqesë Kryesisë së Kuvendit, për miratim.

4.6 Ndryshimi i orarit të punës së Administratës së Kuvendit

Kryesia diskutoi lidhur me orarin e punës së Administratës së Kuvendit dhe mori këtë

V E N D I M

Orari i punës për zyrtarët e Administratës së Kuvendit caktohet prej orës 8 deri në orën 16, ndërsa kur Kuvendi dhe organet e tij mbajnë seanca, orari zgjatet deri në përfundimin e punimeve.

Pushimi gjatë orarit të punës caktohet prej orës 12,00 deri në orën 13,00.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 12:35 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Hartoi:

Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale